



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 815 Prot.

Fier, më 23.01.2026

PROJEKT VENDIM
Nr. 10, datë 23.01. 2026

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë shtetërore financiare të familjes së shtetasit Vladimir Kolonjari, lagjja "Kastriot", Njësia Administrative nr.4, i dëmtuar nga zjarri i datës 17.12.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", Vendimit të Këshillit të Bashkisë Fier nr.118, datë 11.12.2025 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2026*" si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 17.12.2025, shkresës zyrtare nr.1212/1.prot, datë 19.01.2026 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Vladimir Kolonjari dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesë qind) lekë** dhe në anën ndërtimore në vlerën **333 985 (treqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019,

PROPOZON:

1. Dhënie e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Vladimir Kolonjari, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesë qind) lekë**.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **166 992 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gjurmës "ç" "Përcaktimi i ndihmës financiare" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Vladimir Kolonjari është në masën **279 492 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile si dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile

Nasip BANI

Drejtoria Juridike

Esmeralda KAPLLANAJ

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Pranvera ÇINA

KRYETARI

Armando SUBASHI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR**

Nustret AVDULLA

